

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“NAJMA GROUP SHPK

Sot më datë, 16.11.2020 ne shtetasit:

- **Gezim Bajram Mria** , i datëlindjes 15.02.1985, i lindur në Librazhd, Shqipëri, i cili identifikohet me letërnjoftimin ID me nr 034316013 dhe nr. personal I50215020Q, me banim në Rruga, Abaz Dojaka , Ndertesa 2, H2 njesia dministrative Nr 4, 1012 Tirane. , me cilësinë e ortakut të shoqërisë ;
- **Anila (Shefqet) Mria** , e datëlindjes 07.07.1986, lindur ne Hotolisht Librazhd dhe banuese ne Tirane , Abaz Dojaka , Ndertesa 2, H2 njesia dministrative Nr 4, 1012 Tirane, e cila identifikohet me letërnjoftimin ID me nr 0322039756 dhe nr. personal I65707022S , me cilësinë e ortakut të shoqërisë ;

kam redaktuar këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojmë se me vullnet të lire të plotë dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë14.04.2008, “ Për shoqërite tregtare ” në ligjin “ Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit ”, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, vendosëm të krijoj shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “ **Najma Group shpk** ” .

Neni 1

Krijimi

Shoqëria “**Najma Group shpk**” ,është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar (këtu e më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “**Najma Group shpk**” ,është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Adresën:

Rruga e Dibres, DR TIRANA VERI, "Tower Bridge 3 , Kompleksi Orion, Tiranë me nr Pasurie 3/773+4-N1/1

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të biznesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Agjenci udhëtimi, agjenci imobiliare . Veprimtari në fushën e shërbimeve si agjenci udhëtarësh dhe prerje biletash për linjat kombëtare dhe ndërkombëtare, agjenci detare, udhëtimesh, transport pasagjerësh dhe mallrash për transport detar, ajror e tokësor, agjenci spëdicionere dhe shërbimesh portuale në përgjithësi, organizim dhe menaxhim i grupeve turistike shqiptare dhe të huaja për vizita turistike brenda dhe jashtë vendit. Ofrimi i të gjitha shërbimeve të pagesave dhe arketimeve. Ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit për transaksione financiare. Shërbimet në cilësinë e agjentit/këshilltarit financiar për të gjitha veprimtaritë e mesipërme. Ushtrimi i veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime, në cilësinë e agjentit në sigurime. Ushtrimi i veprimtarisë së faktoringut, me ose pa garanci, si dhe i shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për aktivitetin e mësipërm. Dhenia e makinave me qera . Zyre këmbimi valutore, agjent për transferimin e parave . Kancelari.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.500.000 (Dy milion e pesë qind mijë) lekë dhe është i ndarë në 2 kuota , vlera nominale e të cilës është:

- Gezim Mria, 1 kuotë me vlerë nominale 1.225.000 (Një milion e dyqind e njëzet e pesë mijë) lekë, 49 % (dyzet e nente përqind);
 - Anila Mria, 1 kuotë me vlerë nominale 1.275.000 (Një milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, 51 % (pesëdhjetë e një përqind) ;
- të zotëruara nga ortakët e shoqërisë, kuota këto me vlerë të përgjithshme 2.500.000 (Dy milion e pesëqind mijë) lekë të cilat përbëjnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as

me kontribute në shërbime.

Ortakët përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë

Neni 7

Organi Vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët, të cilët mund të përfaqësohen edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Neni 8

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakëve.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB –së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

Administratorët emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë. Asambleja e ortakëve vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/rët, mund të jenë ose jo ortakë.

Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.

Administrator i shoqërisë është Anila Mria , për një periudhë 5 vjeçare sipas ligjit.

Neni 10

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare".


Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 11
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi pasi u redaktua dhe lexua nga ortaku i vetëm themelues, miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare dhe nënshkruhet prej tij.

ORTAKËT THEMELUES

GEZIM MRIA

Gezim Mria


ANILA MRIA

Anila Mria
